KUVENDI
NR 2415 DATE 10.06.19

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE**

**KRYETARI**

Nr._____ prot. Tiranë, më ___/___/ 2019

**Lënda:** **Kërkesë për mocion me debat**

**Drejtuar:** **Z. Gramoz RUÇI**

**Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë**

**K ËT U**

I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit,

Pasi u njohëm me aktin e paprecedentë të Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 "*Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore*" dhe duke e vlerësuar atë si një akt absolutisht të pavlefshëm, të marrë në kapërcim të kompetencave të institucionit të Presidentit dhe në kundërshtim flagrant me parimet kushtetuese dhe demokratike si dhe duke konsideruar se ky akt synon të pengojë në mënyrë të kundraligjshme realizimin e së drejtës kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në pushtetin vendor, bazuar në nenin 98 të Rregullores së Kuvendit kërkojmë zhvillimin e një mocioni me debat në seancën më të parë të Kuvendit për këtë cështje, në përfundim të së cilit propozojmë miratimin e një rezolute sipas draftit bashkangjitur.

**Kryetar i Grupit Parlamentar të PSSH-së**

**Taulant BALLA**